



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**
AKT-MIRATIMI**ORGAN I MIRATUAR****I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT.**

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 53 datë 05.10.2017 Për miratimin e rregullores “Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit” edhe në Çertifikaten e Akreditimit me Nr. Regjistrimi CN 009,

MIRATOJ:

Subjektin:	“ALCERT” shpk.
Me Administrator:	Anila JANI
Komisioni i Çertifikimeve	Anila Jani, Ervin Minga, Fadil Vrapì
Adresa e subjektit:	Rruga “Abdyl Frashëri”, Ndërtesa Nr. 9, H. 3, Ap. 18, Tiranë.
Cel.:	069 750 1178
E-mail:	alcertadm@gmail.com anila.jani@alcert.al

të ushtrojë veprimtarinë si Organizëm i Çertifikimit të Personelit:

Tipi i OMVK-së:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	<u>Fusha e Çertifikimit të personelit për:</u> 1. Personat që përdorin pajisje/implante elektrike lidhur me sigurimin teknik elektrik të klasifikuar në Grupin I, II, III, IV dhe V; 2. Personat që përdorin pajisje nën presion; 3. Instaluesit e Instalimeve Elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV; 4. Instaluesit e linjave të tensionit të lartë mbi 1 kV;

Rregullat teknike/ standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instali mit të vënë në shërbim:	1. S/8/01, rishikimi 00, datë 15.07.2020, bazuar në Urdhrin nr. 3403/1 datë 30.06.2003, miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës; 2. S/8/02, rishikimi 00, datë 15.07.2020; 3. S/8/05, rishikimi 00, datë 15.07.2020, bazuar në VKM nr. 483/2020, Për miratimin e rregullit teknik "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV"; 4. S/8/06, rishikimi 00, datë 15.07.2020, bazuar në VKM nr. 482/2020 Për miratimin e rregullës teknike "Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV";	
Periodha e vlefshmërisë:	Deri më 15.12.2028	
Territori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.	
Personi përgjegjës firmosës:	Anila Jani, Administrator, Menaxhere Cilësie	069 750 1178 anila.jani@alcert.al
OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:	OMI 024 Rishikim 5	

OMVK detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kërkesat dhe kushtet sa më poshtë:

Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.

Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;

Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;

I siguron Ministrin (Strukturës Administrative Përgjegjëse me kërkesë zyrtare) brenda 10 ditësh, kopje të çertifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to si dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e çertifikatave për çdo subjekt;

Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;

Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje çertifikate;

Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;

Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo më pak se 10 vjet.

Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testimet ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të;

Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet të dërgojë Ministrin (SAP) regjistrin e inspektimeve ose çertifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë;

Organi i Miratuar detyrohet të krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrin, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambientet ku OMVK ka kryer vlerësim të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar;

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe

kushtet e përcaktuara në aktin e miratimit, SAP i propozon Ministrit pezullimin e Aktit të Miratimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre;

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, SAP përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për shfuqizimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 14 / 02 / 2025

**ZËVËNDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR**

Belinda Balluku

**Me autorizim
ZËVËNDËSMINISTRI**

